



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS ‘HASAN PRISHTINA’**

**Fakulteti Filozofik**

**STRATEGJIA E ZHVILLIMIT E FAKULTETIT FILOZOFIK**

**2018 - 2023**

**Korrik, 2018**

## PËRMBAJTJA

SHKURTESAT.....	2
DOKUMENET E KONSULTUARA.....	3
VIZIONI.....	4
MISIONI.....	5
I.    Hyrje .....	6
II.   Përmbledhje e kornizës aktuale ligjore dhe dokumenteve strategjike.....	7
III.  Fushat Strategjike të Fokusit dhe Iniciativat Strategjike.....	8
1) Mësimdhënia.....	8
2) Hulumtimi shkencor dhe publikimet.....	8
3) Akreditimi dhe sigurimi i cilësisë.....	9
4) Programet e studimit.....	10
5) Zhvillimi i burimeve njerëzore.....	11
6) Zhvillimi i infrastrukturës .....	12
7) Ndërkombëtarizimi.....	12
8) Shërbimi.....	14
IV.  Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi.....	14

## SHKURTESAT

CEEPUS - Central European Exchange Program for University Studies, (Programi i Shkëmbimit të Evropës Qendrore për Studime Universitare,)

Erasmus + - European Community Action Scheme for the Mobility of University Students (Skema e Veprimit të Komunitetit European për Mobilitetin e Studentëve të Universitetit)

FF – Fakulteti Filozofik;

IHSH - Institutit për Hulumtime Sociale dhe Humanistike;

UP – Universiteti i Prishtinës;

USAID – The United States Agency for International Development (Ndihma e ShBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtare);

## **Vizioni**

Fakulteti Filozofik prijës në zhvillimin e dijes dhe mendimit kritik për një shoqëri të lirë dhe demokratike.

## **Misioni**

Fakulteti Filozofik ka për qëllim:

- Avancimin e dijes, mendimit kritik dhe kreativitetit;
- Ofrimin e programeve dhe mjedisi studimor cilësor;
- Kultivimin i vlerave të një shoqërie demokratike, të barabartë, gjithëpërfshirëse dhe diversive;
- Sigurimin e një mjedisi të kultivuar, miqësor dhe bashkëpunues brenda institucionit.

## I. Hyrje

Fakulteti Filozofik është njësisia e parë akademike e arsimit të lartë në Kosovë, e cila u themelua me 30 tetor 1960, që për mision pati dhe ka edukimin e mirëfilltë të të rinjve të Kosovës, për t'i përgatitur si qytetarë të denjë e të dobishëm për vendin. Roli i themelimit të Fakultetit Filozofik gjatë tërë kohës ka qenë dhe mbetet burim i reflektimit dhe ndryshimeve politike, shoqërore, në përparim të vendit dhe shoqërisë kosovare. Fakulteti Filozofik ka qenë prijës i shumë proceseve jetike për Kosovën, pavarësisht sfidave me të cilat u ballafaqua gjatë kohës së funksionimit të tij. Në Fakultetin Filozofik, aktualisht funksionojnë shtatë departamente, si:

1. Departamenti i Historisë
2. Departamenti i Filozofisë
3. Departamenti i Sociologjisë
4. Departamenti i Psikologjisë
5. Departamenti i Shkencave Politike
6. Departamenti i Punës Sociale
7. Departamenti i Antropologjisë.

Në kuadër të këtyre departamenteve, procesi mësimor organizohet në shtatë (7) programe BA: Antropologji (Drejtimet Arkeologji dhe Antropologji Kulturore), Filozofi, Histori, Psikologji, Punë Sociale, Sociologji dhe Shkenca Politike; gjashtë (6) programe MA: Filozofi, Histori – Koha e Re, Psikologji Shkollore dhe Këshillimi, Sociologji dhe Integritet Evropiane dhe Administratë Publike; Arkivistikë, dy (2) programe në doktoratë: në Histori dhe Sociologji.

Fakulteti Filozofik me programet e tij të studimit që ofron, mbetet si institucion shumë i besueshëm dhe atraktiv për të rinjtë e Kosovës dhe më gjerë. Fakulteti Filozofik gjatë viteve të fundit ka punuar në forcimin dhe zgjerimin e kapaciteteve akademike, duke ndjekur hapat e zhvillimit dhe trendëve në arsimin e lartë në Evropë dhe më gjerë

Strategjia e zhvillimit të Fakultetit Filozofik 2018 - 2023 do t'i adresojë tetë çështje lidhur me ngritjen e cilësisë dhe shërbimeve në këtë institucion. Në kuadër të fokusit të këtyre tetë fushave strategjike, janë të parapara një numër i konsiderueshëm i iniciativave për periudhën kohore referuese, përgjegjësit e realizimit të këtyre iniciativave dhe një kosto që secila nga këto fusha kërkon për zbatimin e kësaj strategjie të zhvillimit, dhe në fund është e paraparë që të bëhet një monitorim dhe raportim i realizimit të kësaj strategjie, sipas dinamikës së paraparë, që është specifikuar në planin e veprimit.

## **II. Përmbledhje e kornizës aktuale ligjore dhe dokumenteve strategjike**

Plani strategjik i Universitetit të Prishtinës ‘‘Hasan Prishtina’’ 2017 – 2019;

Statuti i Universitetit të Prishtinës;

Ligji për Arsimin e Lartë i Republikës së Kosovës, 2010;

Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës 2017 – 2021;

Rregullore për sigurimin e Cilësisë dhe vlerësimit në Universitetin e Prishtinës, 2016;

Rregullore për mobilitet Akademik të studentëve në Universitetin e Prishtinës, 2017;

Udhëzues për shqyrtimin dhe Rishqyrtimin e Syllabusit, 2018;

Udhëzues për vlerësimin e lëndëve nga studentët dhe përdorimi i tyre në UP, 2018;

Strategjia për Veprimtari Kërkimore Shkencore/Artistike dhe Zhvillimore 2013 – 2015;

Universiteti i Prishtinës – Asistencë Teknike për Zyrën e Rektorit, raporti i USAID 2013

### **III. Fushat Strategjike të Fokusit dhe Iniciativat Strategjike**

#### **1. Mësimdhënia**

Fakulteti Filozofik është i përkushtuar të ofrojë mësimdhënie gjithnjë e më cilësore. Në përputhje me zhvillimet historike dhe aktuale në secilën fushë në të cilën Fakulteti Filozofik ofron studime, me zhvillimet historike dhe shoqërore në Kosovë, rajon dhe më gjerë, me të dhënat zhvillimore të studentëve, që zgjedhin Fakultetin Filozofik për të studiuar, kjo njësi akademike do të ofrojë:

Mësimdhënie interaktive e bazuar në teori dhe praktikë më të mira bashkëkohore me në qendër studentin/en;

Mësimdhënie, që integron pjesën relevante praktike në përputhje me specifikat e programeve përkatëse të studimit;

Mësimdhënie e mbështetur në punë dhe projekte hulumtuese sipas specifikave;

Mësimdhënie, që integron mësimnxënien duke bërë (*learning by doing*);

Mësimdhënie e bazuar në një raport të arsyeshëm për kontekstin profesor – student, duke shkuar drejt zbatimit të standardeve evropiane.

#### **2. Hulumtimi shkencor dhe publikimet**

Fakulteti Filozofik e sheh shumë të rëndësishëm komponentin hulumtues. Fakulteti Filozofik do t'i kushtojë rëndësi të veçantë rritjes së kapaciteteve hulumtuese, burimeve dhe teknologjisë në pesë (5) vitet e ardhshme. Fakulteti Filozofik do të:

- Rrisë bashkëpunimin ndërkombëtar përmes projekteve hulumtuese, konferencave shkencore, seminareve, simpoziumeve me pjesëmarrjes të stafit akademik dhe studentët;
- Rrisë bashkëpunimin me institucionet vendore si institucione shtetërore, institute kërkimore – shkencore, institucione publike, organizatat joqeveritare, komunitete të ndryshme, etj.
- Zhvillimi i Institutit për Hulumtime Sociale dhe Humanistike (IHSH);
- Investimi në laboratore të departamenteve specifike (psikologji, punës sociale);
- Investimi në licenca dhe trajnimi i stafit për softuerë adekuatë;
- Abonimi në databaza të revistave ndërkombëtare dhe librave elektronike.



- Fakulteti Filozofik do t'i kushtojë rëndësi dhe do të rrisë kapacitetet për botimin e punës shkencore hulumtuese të stafit akademik dhe studentëve. Politikat e publikimit do të përqendrohen në aspektet e mëposhtme:
- Botimi i monografive, artikujve shkencorë, teksteve universitare, kumtesave e konferencave shkencore, ligjëratave të autorizuara, doracakëve dhe katalogjeve;
- Botuesit ndërkombëtarë dhe vendorë duhet të jenë kredibilë;
- Fakulteti Filozofik do të përkrahë teknikisht dhe financiarisht aktivitetet hulumtuese dhe publikimet e stafit akademik;
- Botimi dhe indeksimi i Buletinit të Fakultetit Filozofik dhe Njohja.

### **3. Akreditimi dhe sigurimi i cilësisë**

Fakulteti Filozofik njih dhe vlerëson lart procesin e akreditimit të programeve akademike nga Agjencia e Kosovës për Akreditim. Vlerësimi i programeve nga ekspertët ndërkombëtarë dhe zbatimi i rekomandimeve ka ngritur cilësinë dhe ka mundësuar adaptimin e praktikave ndërkombëtare në universitet. Me qëllim përmirësimin e përgatitjes së mëtijshme për akreditim, Fakulteti Filozofik do të:

- Rrisë efikasitetin në zbatimin e rekomandimeve të ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit;
- Përditësojë programet në riakreditim në përputhje me mësimet e mësuara (*lessons learned*) dhe praktikat më të mira;
- Përmirësojë procesin e vlerësimit të brendshëm të mësimdhënies dhe programeve;
- Përmirësojë komunikimin dhe llogaridhënien e brendshme në raport me obligimet e secilit departament, përgjegjësve për programet përkatëse dhe menaxhmentit të fakultetit;
- Fakulteti Filozofik do të zbatojë obligimet nga korniza ligjore në fuqi për mekanizmat dhe aktivitetet për sigurimin e cilësisë dhe do të bashkëpunojë ngushtë me aktorët relevantë në këtë drejtim.

#### **4. Programet e studimit**

Fakulteti Filozofik ka një traditë të konsoliduar për ofrimin e programeve akademike në të tre nivelet e studimit (BA, MA dhe doktoraturë), të cilat kanë zgjuar interesin e studentëve dhe të shoqërisë. Aktualisht në Fakultetin Filozofik janë funksionale shtatë (7) programe BA: Antropologji (Drejtimit Arkeologji dhe Antropologji Kulturore), Filozofi, Histori, Psikologji, Punë Sociale, Sociologji dhe Shkenca Politike; gjashtë (6) programe MA: Filozofi, Histori – Koha e Re, Psikologji Shkollore dhe Këshillimi, Sociologji dhe Integritet Evropian dhe Administratë Publike; Arkivistikë, dy (2) programe në doktoratë: në Histori dhe Sociologji

Fakulteti Filozofik ofron programe akademike, të cilat kanë (a) interes publik, (b) treg të punës dhe (c) administratës shtetërore. Të gjitha programet për të cilat Fakulteti Filozofik aplikon për riakreditim apo akreditim bazohen në evidencë, përveçse në dokumente relevante shtetërore dhe ndërkombëtare. Në pesë (5) vitet e ardhshme Fakulteti Filozofik synon riakreditimin e të gjitha programeve ekzistuese. Gjithashtu, Fakulteti Filozofik në përputhje me kapacitetet kadrovike dhe në konsultim me departamentet synon akreditimin e programeve në vijim:

- Program master në Marrëdhënie Ndërkombëtare & Diplomaci
- Program master në Psikologji komuniteti dhe klinike
- Program master në Antropologji dhe Trashëgimi Kulturor
- Programi master në Punë Sociale
- Programi Interdisciplinar i Doktoraturës në Shkencat Humane dhe Sociale (Profile: Filozofi, Histori, Psikologji, Sociologji, Shkenca Politike).
- Program master në Studime gjinore

Fakulteti Filozofik synon gjithashtu të akreditojë dhe ofrojë programe profesionale trajnimesh në kuadër të shërbimeve për palë të treta.

#### **5. Zhvillimi i burimeve njerëzore**

Fakulteti Filozofik synon të ndjekë një politikë aktive kadrovike e bazuar në:

- a) rekrutim të stafit të ri akademik asistentë, lektorë dhe mësimdhënës;
- b) avancimin e vazhdueshëm profesional të stafit të rregullt përmes ofrimit të trajnimeve, mbështetjes financiare dhe të tjera;

- c) rekrutim të personelit të ri administrativ për plotësimin e vendeve vakante ekzistuese dhe plotësimin e nevojave në tërësi të Fakultetit Filozofik;
- d) avancimin e vazhdueshëm profesional të personelit administrativ përmes ofrimit të trajnimeve, shkëmbimit të përvojave dhe pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare, etj.

Aktualisht Fakulteti Filozofik ka gjithsej 53 staf akademik të rregullt të ndarë në këto kategori: shtatë (7) profesorë të rregullt, njëmbëdhjetë (11) profesorë të asociuar, katërbëdhjetë (14) profesorë asistentë, një (1) lektor dhe njëzet (20) asistentë. Për sa i përket personelit administrativ Fakulteti Filozofik ka shtatëmbëdhjetë (17) të punësuar.

Planifikimi për periudhën pesë (5) vjeçare 2018/23 për staf akademik sipas departamenteve është si vijon:

- Departamenti i Antropologjisë: Tre (3) profesorë të zgjedhur, gjashtë (6) asistentë.
- Departamenti i Filozofisë: Tre (3) profesorë të zgjedhur dhe katër (4) asistentë.
- Departamenti i Historisë: Dy (2) profesorë të zgjedhur, katër (4) asistentë.
- Departamenti i Psikologjisë: Tre (3) profesorë të zgjedhur, tre (3) asistentë.
- Departamenti i Punës Sociale: Katër (4) profesorë të zgjedhur, katër (4) asistentë
- Departamenti i Sociologjisë: Katër (4) profesorë të zgjedhur, katër (4) asistentë.
- Departamenti i Shkencave Politike: Tre (3) profesorë të zgjedhur, tre (3) asistentë.

Në përmbledhje, Fakulteti Filozofik planifikon zgjedhjen/avancimin e njëzetedy (22) profesorëve të zgjedhur dhe njëzetetë (28) asistentë.

Planifikimi pesë (5) vjeçar për personel administrativ për Fakultetin Filozofik

Fakulteti Filozofik planifikon punësimin për plotësimin e pesë (5) vendeve të punës të mbetura vakante për arsye të ndryshme. Gjithashtu, planifikohen tre (3) vende pune për shkak pensionimi të personelit aktual. Në fund, planifikohet një (1) vend i ri pune për nevoja të fakultetit. Pra, gjithsej planifikohet nëntë (9) vende të reja pune në Fakultetin Filozofik.

## 6. Zhvillimi i infrastrukturës

Fakulteti Filozofik aktualisht posedon hapësirë për mësim 1664 m<sup>2</sup>, 64 (860 m<sup>2</sup>) kabinete për stafin akademik, një bibliotekë (280 m<sup>2</sup>), salla e leximit (280 m<sup>2</sup>), dy laboratore secili nga 30 m<sup>2</sup>, 8 korridore (970 m<sup>2</sup>), nyje sanitare 20 copë (80 m<sup>2</sup>), 15 zyra për administratë (357 m<sup>2</sup>), 4 plato (603 m<sup>2</sup>), 1 depo (60 m<sup>2</sup>), 1 ashensor (12 m<sup>2</sup>), 1 bufe (12 m<sup>2</sup>). Hapësira e shfrytëzueshme për staf akademik dhe administrativ në total 5188.

Fakulteti Filozofik synon të rinovojë hapësirat, të cilat e kanë një gjë të tillë të nevojshme. Prioritet në këtë drejtim kanë:

- rregullimi i një salle për mbledhjet e Këshillit të Fakultetit Filozofik;
- renovimi i amfiteatrove dhe auditorëve të mësimi;
- renovimi i çatisë dhe fasadës së godinës së fakultetit;
- investimi në mjete konkretizimi;
- funksionalizimi i sallës - muze;
- pajisja me aparatura për qasje dhe pengim të valëve të internetit;
- blerja e lexuesit optik për nevoja të fakultetit;
- blerja e një serveri adekuat për nevoja të fakultetit;
- renovimi i nyjeve sanitare;
- funksionalizimi, estetizmi i mjediseve sociale dhe bufesë brenda fakultetit.

## 7. Ndërkombëtarizimi

Fakulteti Filozofik ka rritur përpjekjet dhe efikasitetin në drejtim të ndërkombëtarizimit. Disa departamente janë pjesë e rrjeteve ndërkombëtare profesionale, projekteve afatshkurtra dhe afatmesme të hulumtimit dhe të ofrimit të shërbimeve. Një pjesë e stafit e ka pjesë të agjendës ditore aktivitetet me karakter rajonal dhe ndërkombëtar. Sidoqoftë, Fakulteti Filozofik konsideron thelbësore zhvillimin e mëtejshëm në çdo aspekt dhe program të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në këtë kontekst, mund të përmenden si të rëndësishme veçanërisht anëtarësia e Departamentit të Filozofisë në Federatën Botërore të Filozofisë, pjesë e rrjetit Filozofia dhe Interdisiplinariteti në kuadër të CEEPUS, pjesë e Rrjetit të Frankofonisë; Departamenti i Psikologjisë pjesë e Projektit d43 me Universitetin e Illinoisit në Çikago, pjesë e Rrjetit Ndërkombëtar për Zhvillim Pozitiv të Rinjve, pjesë e projektit Impulse në kuadër të Horizon 2020; Departamenti i Punës Sociale është anëtare e Asociacionit Ndërkombëtar të Shkollave të Punës Sociale, Asociacionit Evropian të Shkollave të Punës Sociale, Asociacionit të Shkollave të Punës Sociale të Evropës Lindore dhe Juglindore, të Rrjetit për Udhëheqje të Grave në Evropën Juglindore. Gjithashtu, Fakulteti Filozofik me departamentet respektive është pjesë në vazhdimësi e programeve të Erasmus +. Në fund, Fakulteti Filozofik ka marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione rajonale dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe institucioneve kërkimore, duke qenë pjesë aktive e projekteve të përbashkëta ndërkombëtare.

Fakulteti Filozofik do të vazhdojë bashkëpunimet, projektet dhe anëtarësitë aktuale ndërkombëtare. Gjithashtu, do të rrisë përpjekjet për ndërkombëtarizim edhe më të madh të fakultetit me njësitë përkatëse:

- Rritja e mobilitetit të stafit akademik në hapësirën evropiane dhe më gjerë;
- Rritja e bashkëpunimit ndëruniversitar për aplikim për programe të përbashkëta studimore MA përmes Erasmus +;
- Pjesëmarrja me projekte kërkimore ndërdisiplinare ndërkombëtare në Horizon 2020;
- Organizimi dhe pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare;
- Përfshirja e stafit dhe studentëve në Universitetin Veror të Prishtinës;
- Ftesa e profesorëve vizitorë me renome nga universitete rajonale dhe ndërkombëtare;
- Përfshirja e profesorëve me renome në mësimdhënie për fusha ekspertize specifike dhe në nevojë në Kosovë;
- Krijimi i kushteve për tërheqjen e studentëve ndërkombëtarë në kuadër të programeve të shkëmbimit të studentëve;
- Inkurajimi dhe mbështetja e studentëve për mobilitet.

## **8. Shërbimi**

Fakulteti Filozofik synon përsosjen e cilësisë së shërbimeve për studentët, profesoratin dhe palët e treta (alumni, komuniteti, universitetet e tjera publike, organizatat e shoqërisë civile, mediat, etj.). Prioritetet në këtë drejtim janë:

- Zbatimi i përpiktë i kërkesave statutare dhe akteve nënligjore në raport me shërbimet ndaj studentëve;
- Ridizajnimi, rifreskimi i faqes zyrtare të internetit të Fakultetit Filozofik;
- Funkcionalizimi i e-arkivit të Fakultetit Filozofik;
- Përmirësimi i komunikimit të brendshëm dhe të konsultimeve midis profesoratis, studentëve, administratës dhe menaxhmentit;
- Përditësimi dhe pasurimi i fondit të literaturës në bibliotekë;
- Ndërtimi dhe funksionalizimi i bibliotekës elektronike;
- Abonimi në databaza elektronike;
- Përsosja e shërbimeve për njerëzit me aftësi të kufizuara.

## **IV. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi**

Fakulteti Filozofik do të monitorojë në vazhdimësi zbatimin e kësaj strategjie. Monitorimi është në përgjegjësi të personave të caktuar nga dekani i fakultetit.

Vlerësimi i zbatimit të kësaj strategjie do të bëhet me shkrim në baza periodike dy herë në vit: në fund të çdo gjashtëmuajori (qershor dhe janar). Raporti vlerësues diskutohet dhe miratohet në Këshillin e Fakultetit Filozofik. Jo më larg se gjashtë (6) muaj para përfundimit të periudhës për të cilën vlen kjo strategji, do të fillojë puna për hartimin e strategjisë pasardhëse.

Raportimi për zbatimin e planit veprues, që është pjesë e kësaj strategjie, bëhet nga shefat e departamenteve, personat e autorizuar nga dekani dhe prodekanët e fushave përkatëse. Nëse kërkohet nga organet qendrore të universitetit, raportimin do ta bëjë dekani ose personi i autorizuar nga ai.